**VENDIM**
**Nr.42, datë 15.6.2011**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR EKSPERTIN KONTABËL TË AUTORIZUAR TË BANKAVE DHE DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA"**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 48, pika 1 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për ekspertin kontabël të autorizuar të bankave dhe degëve të bankave të huaja" dhe aneksin e saj, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi nr.6 datë 29.1.2003 i Këshillit Mbikëqyrës "Për miratimin e rregullores "Për ekspertin kontabël të autorizuar të bankave", i ndryshuar.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
**Ardian Fullani**

**RREGULLORE**
PËR EKSPERTIN KONTABËL TË AUTORIZUAR TË BANKAVE DHE DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
**Objekti**

Kjo rregullore ka për objekt:
a) përcaktimin e kritereve, kushteve dhe procedurave për miratimin e ekspertit kontabël të autorizuar të bankave dhe degëve të bankave të huaja nga Banka e Shqipërisë;
b) përcaktimin e auditimit për qëllime të Bankës së Shqipërisë nga eksperti kontabël i autorizuar i bankave dhe degëve të bankave të huaja;
c) përcaktimin e marrëdhënieve midis ekspertit kontabël të autorizuar të bankave e degëve të bankave të huaja, dhe Bankës së Shqipërisë.

Neni 2
**Baza juridike**

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:
a) nenit 12, shkronja "a" dhe të nenit 43 shkronja "c", të ligjit nr.8269 datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar (këtu e më poshtë në këtë rregullore referuar si ligji "Për Bankën e

Shqipërisë";

b) nenit 47, nenit 48, pika 1 dhe nenit 49, pika 3 e ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" (këtu e më poshtë në këtë rregullore referuar si ligji "Për bankat");

c) ligjit nr.10 091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" (këtu e më poshtë në këtë rregullore referuar si ligji "Për auditimin ligjor");

d) ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar (këtu e më poshtë në këtë rregullore referuar si ligji "Për kontabilitetin").

Neni 3
**Subjektet**

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë për ushtrimin e veprimtarive bankare dhe/ose financiare në Republikën e Shqipërisë (këtu e më poshtë në këtë rregullore referuar si "banka").

Neni 4
**Përkufizime**

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjet "Për bankat", "Për auditimin ligjor" dhe në ligjin "Për kontabilitetin".

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

a) "ekspert kontabël i autorizuar", është shoqëria audituese sipas përkufizimit të nenit 2, pika 20 e ligjit "Për auditimin ligjor";

b) "ekspert individual i personit juridik", është ortaku kryesor i auditimit sipas përkufizimit të nenit 2, pika 12 të ligjit "Për auditimin ligjor".

KREU II
KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR DHE PROCEDURA E MIRATIMIT NGA BANKA E SHQIPËRISË

Neni 5
**Kriteret**

1. Banka e Shqipërisë miraton si ekspert kontabël të autorizuar vetëm personin juridik të licencuar apo të regjistruar në regjistrin publik të ekspertëve kontabël për ushtrimin e kësaj veprimtarie në Republikën e Shqipërisë, i cili përveç kritereve të përcaktuara në nenin 48 të ligjit "Për bankat" plotëson dhe kriteret e mëposhtme:

a) të ketë 3 (tre) vjet eksperiencë në fushën e auditimit ligjor të pasqyrave financiare të bankave ose subjekteve të tjera financiare që mbajnë kontabilitetin sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF);

b) të paktën dy prej ortakëve ose të punësuarve të shoqërisë të kenë titull profesional "ekspert kontabël i regjistruar";

c) gjatë dy viteve të fundit, nga Banka e Shqipërisë nuk është kërkuar ribërja e auditimit të kryer prej tij sipas përcaktimeve të nenit 51, pika 1 të ligjit "Për bankat";

d) të ketë etikë të lartë profesionale; dhe

e) të mos ketë konflikt interesash me bankën që auditon, sipas përcaktimeve të ligjit "Për auditimin ligjor".

2. Eksperti individual i personit juridik të regjistruar në regjistrin publik të ekspertëve kontabël, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të ketë 3 (tre) vjet eksperiencë në fushën e auditimit të pasqyrave financiare të bankave ose

subjekteve të tjera financiare që mbajnë kontabilitetin sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF);

b) të ketë etikë të lartë profesionale, dhe;

c) të mos ketë konflikt interesash me bankën që auditon.

3. Banka siguron plotësimin e kritereve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni për ekspertin individual të personit juridik.

Neni 6

**Dokumentacioni**

1. Për miratimin e ekspertit kontabël të autorizuar, banka paraqet në Bankën e Shqipërisë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimin e asamblesë së aksionerëve të bankës ose të organit përkatës të bankës mëmë (në rastin e degës së bankës së huaj) për emërimin e ekspertit kontabël të autorizuar;

b) programin e auditimit të bankës;

c) letrën e angazhimit të ekspertit kontabël ose kontratën e shërbimit të ofruar, e cila do të përmbajë përveç të tjerave edhe angazhimin për zbatimin e kërkesave të ligjit "Për bankat" dhe të kësaj rregulloreje;

d) një dokument që vërteton se shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar ka jo më pak se 3 (tri) vite eksperiencë në fushën e auditimit të pasqyrave financiare të bankave ose të subjekteve të tjera financiare që mbajnë kontabilitetin sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF);

e) një vërtetim nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) në lidhje me rezultatet e kontrollit më të fundit të cilësisë për ekspertin kontabël të autorizuar;

f) një deklaratë mbi plotësimin e kritereve të përcaktuara në nenin 5, pika 1, shkronja "e" të kësaj rregulloreje.

2. Dokumentacioni i kërkuar në pikat e mësipërme paraqitet në gjuhën shqipe, në origjinal ose në fotokopje të noterizuar. Në rastin e dokumentacionit në gjuhë të huaj, ky i fundit paraqitet në origjinal ose fotokopje të noterizuar dhe duhet të shoqërohet nga kopja e përkthyer dhe e noterizuar në gjuhën shqipe.

Neni 7

**Procedurat për miratimin e ekspertit kontabël të autorizuar**

1. Banka paraqet në Bankën e Shqipërisë, jo më vonë se muaji korrik i çdo viti, kërkesën dhe dokumentacionin e plotë me shkrim për miratimin e ekspertit kontabël të autorizuar, duke plotësuar të gjitha kërkesat e kreut II të kësaj rregulloreje.

2. Banka e Shqipërisë shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues në përputhje me kushtet dhe kriteret e kësaj rregulloreje.

3. Nëse dokumentacioni i paraqitur sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje nuk është i plotë, Banka e Shqipërisë brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga paraqitja e tij, njofton bankën për mangësitë e evidentuara. Banka plotëson mangësitë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga njoftimi i Bankës së Shqipërisë, përndryshe kërkesa konsiderohet si e paparaqitur.

4. Data e pranimit të kërkesës për miratimin e ekspertit kontabël të miratuar, konsiderohet data kur kërkuesi ka plotësuar të gjitha kërkesat mbi dokumentacionin e kërkuar sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje.

5. Banka e Shqipërisë brenda 1 (një) muaji nga data e paraqitjes së plotë të kërkesës miraton ose refuzon ekspertin kontabël të autorizuar të propozuar nga banka.

Neni 8

**Miratimi i ekspertit kontabël të autorizuar**

1. Banka e Shqipërisë miraton si ekspert kontabël të autorizuar, vetëm personin juridik të emëruar nga banka, të autorizuar për ushtrimin e veprimtarisë së auditimit ligjor në Republikën e

Shqipërisë dhe të regjistruar në “Regjistrin publik të ekspertëve kontabël të regjistruar”, i cili plotëson kriteret dhe kërkesat e kësaj rregulloreje, brenda afateve dhe procedurave të përcaktuara në nenin 7 të saj.

2. Në rastin e riemërimit të të njëjtit ekspert kontabël të autorizuar për vitin pasardhës financiar, banka njofton Bankën e Shqipërisë, duke paraqitur bashkëlidhur këtij njoftimi, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimin e bankës për riemërimin e ekspertit kontabël të autorizuar;

b) programin e auditimit të bankës;

c) letrën e angazhimit të ekspertëve kontabël ose kontratën e shërbimit të ofruar, e cila do të përmbajë përveç të tjerave edhe angazhimin për zbatimin e kërkesave të ligjit “Për bankat” dhe të kërkesave të kësaj rregulloreje.

3. Banka, për ndryshimin e ekspertit kontabël të autorizuar, brenda vitit financiar për të cilin është miratuar sipas pikës 1 të këtij neni, merr miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë. Banka, për këtë qëllim, paraqet në Bankën e Shqipërisë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën për ndryshimin e ekspertit kontabël të autorizuar;

b) shkaqet dhe arsyet e ndryshimit të ekspertit kontabël të autorizuar;

c) dokumentacionin e kërkuar sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje.

4. Në lidhje me kërkesën e bankës për ndryshimin e ekspertit kontabël të autorizuar brenda të njëjtit vit financiar, Banka e Shqipërisë respekton të njëjtat procedura dhe afate si ato të përcaktuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje. Banka e Shqipërisë miraton ose refuzon kërkesën e bankës për ndryshimin e ekspertit kontabël të autorizuar brenda vitit financiar, i cili është miratuar sipas pikës 1 të këtij neni.

5. Refuzimi i kërkesës për miratimin ose ndryshimin e ekspertit kontabël të autorizuar shoqërohet nga Banka e Shqipërisë me arsyetimin përkatës.

6. Banka e Shqipërisë refuzon miratimin e ekspertit kontabël të autorizuar edhe në rastin kur gjykon se eksperti kontabël i autorizuar, në auditimin e mëparshëm, nuk ka vepruar në përputhje dhe/ose nuk ka plotësuar në mënyrë të mjaftueshme kërkesat e ligjit “Për bankat” dhe të kësaj rregulloreje.

## KREU III
## AUDITIMI I EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR

### Neni 9
### **Auditimi**

1. Eksperti kontabël i autorizuar auditon në baza individuale dhe/ose të konsoliduara llogaritë kontabël dhe raportet financiare të bankës sipas kërkesave të ligjit “Për auditimin ligjor”; ligjit “Për kontabilitetin”; ligjit “Për bankat”; standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, si dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi;

2. Pasqyrat financiare të bankës auditohen çdo vit financiar nga eksperti kontabël i autorizuar.

### Neni 10
### **Auditimi për qëllime të Bankës së Shqipërisë**

1. Auditimi për qëllime të Bankës së Shqipërisë është procesi i:

a) auditimit të pasqyrave dhe raporteve financiare sipas përcaktimeve të metodologjisë së raportimit dhe përmbajtjes së raporteve financiare, të përcaktuara me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë;

b) vlerësimit të përputhshmërisë me rregullat e administrimit të rrezikut;

c) vlerësimit të funksioneve të sistemit të kontrollit të brendshëm;

d) vlerësimit të gjendjes dhe administrimit të sistemeve të informacionit.

Neni 11

**Kontrolli dhe vlerësimi i raportimeve të bankës në Bankën e Shqipërisë**

1. Eksperti kontabël i autorizuar kontrollon rregullshmërinë, saktësinë dhe plotësinë e raportimeve të bankës të paraqitura në Bankën e Shqipërisë në përputhje me kërkesat rregullative në fuqi të miratuara nga Banka e Shqipërisë.

2. Eksperti kontabël i autorizuar, bazuar në kontrollin e ushtruar sipas pikës 1 të këtij neni, vlerëson nëse raportimet janë kryer ose jo në përputhje me përcaktimet e ligjit "Për bankat" dhe/ose me aktet nënligjore/rregulloret e Bankës së Shqipërisë dhe nëse ato pasqyrojnë në mënyrë realiste dhe objektive gjendjen financiare të bankës.

Neni 12

**Vlerësimi i përputhshmërisë me rregullat e administrimit të rrezikut**

1. Eksperti kontabël i autorizuar kontrollon dhe vlerëson përputhshmërinë e rregullave të administrimit të rrezikut të bankës, në përputhje me përcaktimet e ligjit "Për bankat" dhe kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës të miratuar nga Banka e Shqipërisë në zbatim të tij.

2. Eksperti kontabël i autorizuar vlerëson mjaftueshmërinë e sistemeve të administrimit të rreziqeve të bankës (rreziku i kredisë, rreziku i likuiditetit, rreziqet e tregut etj.) duke u bazuar në vlerësimin e:

a) përputhshmërisë me kërkesat për strukturat organizative në lidhje me administrimin e çdo rreziku të veçantë;

b) politikave dhe procedurave për administrimin e çdo rreziku të veçantë si dhe të zbatimit të tyre;

c) mjaftueshmërisë së identifikimit, matjes dhe monitorimit të çdo rreziku të veçantë;

d) mjaftueshmërisë dhe eficiencës së sistemit të kontrollit të brendshëm në lidhje me administrimin e çdo rreziku të veçantë.

Neni 13

**Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm**

1. Eksperti kontabël i autorizuar kryen një vlerësim të veçantë të sistemit të kontrollit të brendshëm të bankës. Eksperti kontabël i autorizuar vlerëson nëse:

a) banka ka ngritur një sistem kontrolli të brendshëm të sigurt dhe efiçent, në përputhje me përcaktimet e ligjit "Për bankat" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;

b) banka ka krijuar njësinë e kontrollit të brendshëm, si njësi të pavarur nga pikëpamja funksionale dhe organizative nga njësitë e tjera organizative të bankës, të cilat kontrollon;

c) banka ka krijuar sistem kontrolli të brendshëm të përshtatshëm për të shmangur konfliktin e interesave;

d) banka ka siguruar një numër të mjaftueshëm personeli, me kualifikime të duhura profesionale dhe përvojë, për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, në mënyrë proporcionale me madhësinë, llojin, vëllimin dhe kompleksitetin e veprimtarive të saj;

e) njësia e kontrollit të brendshëm funksionon në përputhje me përcaktimet e ligjit "Për bankat" dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij, si dhe nëse planet vjetore të punës të kësaj njësie janë të përshtatshme dhe/ose të mjaftueshme.

Neni 14

**Vlerësimi i sistemit të informacionit**

1. Eksperti kontabël i autorizuar kryen një vlerësim të veçantë të gjendjes dhe të mjaftueshmërisë së sistemit për administrimin e informacionit të bankës. Për këtë qëllim, eksperti

kontabël duhet:

a) të përcaktojë paraprakisht qëllimin dhe thellësinë e vlerësimit bazuar në vlerësimin e rrezikut (risk-based);

b) të zbatojë metodat dhe procedurat e këtij vlerësimi bazuar në vlerësimin e rrezikut (risk-based);

c) të verifikojë përputhshmërinë e sistemit të administrimit të informacionit me kërkesat/përcaktimet e ligjit "Për bankat" dhe/ose aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

2. Bazuar në vlerësimin e sistemit të informacionit sipas pikës 1 të këtij neni, eksperti kontabël i autorizuar përcakton rreziqet kryesore, ndaj të cilave banka është e ekspozuar.

## KREU IV
## RAPORTI VJETOR I EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR

### Neni 15
### **Qëllimi dhe përmbajtja e raportit vjetor të ekspertit kontabël të autorizuar**

1. Në bazë të auditimit të pasqyrave financiare të bankës për vitin ushtrimor, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin përkatës të auditimit të kryer sipas:

a) nenit 9, pika 1 të kësaj rregulloreje duke shprehur njëkohësisht dhe opinionin e tij të qartë nëse pasqyrat financiare të audituara japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit dhe performancës financiare të bankës;

b) nenit 10 të kësaj rregulloreje, raport i cili përmban:

i) një vlerësim të veçantë mbi:

- rregullsinë, saktësinë dhe plotësinë e raporteve financiare të bankës që paraqiten në Bankën e Shqipërisë,
- përputhshmërinë me rregullat e administrimit të rrezikut,
- mjaftueshmërinë e sistemeve të administrimit të rrezikut, të funksionit të përputhshmërisë dhe të sistemit të kontrollit të brendshëm,
- gjendjen e sistemit të informacionit dhe të mjaftueshmërisë së sistemeve për administrimin e informacionit në bankë,
- zbatimin e rekomandimeve të lëna nga eksperti kontabël i autorizuar për vitin e kaluar financiar;

ii) rekomandime për përmirësimin e politikave, proceseve dhe procedurave në lidhje me administrimin e rrezikut në përputhje me pikën 2 të nenit 12 të kësaj rregulloreje.

## KREU V
## DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

### Neni 16
### **Kryerja e takimeve**

Banka e Shqipërisë mban kontakte dhe zhvillon takime me ekspertin kontabël të autorizuar të bankës sa herë e gjykon të nevojshme.

### Neni 17
### **Të fundit**

1. Banka paraqet në Bankën e Shqipërisë “letrën për administratorët”, që eksperti kontabël i autorizuar përgatit për drejtuesit e lartë të tyre. Lëshimi i “letrës për administratorët” është pjesë e letrës së angazhimit/kontratës të shërbimit të ofruar.

2. Raporti vjetor i ekspertit kontabël të autorizuar i përgatitur sipas kërkesave të nenit 15 të kësaj rregulloreje, së bashku me vlerësimet e komitetit të kontrollit dhe “letrën për administratorët”, i dërgohen Bankës së Shqipërisë brenda gjashtëmujorit të parë të vitit pasardhës.

## ANEKS SHPJEGUES
## MBI VLERËSIMIN E RREZIQEVE NË REFERENCË TË RAPORTIT TË PËRCAKTUAR NË NENIN 15 TË KËSAJ RREGULLOREJE

Në përmbushjen e detyrimeve sipas nenit 15 të rregullores, auditori i jashtëm i referohet shpjegimeve në këtë aneks, por duke mos u kufizuar në formën e paraqitjes apo thellësinë e vlerësimit.

1. Kapitali i bankës

- Një vlerësim mbi kapitalin e bankës para dhe pas rregullimeve të kryera si pasojë e sugjerimeve të auditorit.
- Përgatitjen e listës së aksionerëve kryesorë të bankës (shembull: listën e aksionerëve me të drejta vote mbi 5 për qind, etj.).
- Vlerësimin e ndryshimeve në strukturën e aksionerëve brenda harkut kohor 1-vjeçar dhe vlerësimin e lidhjeve mes aksionerëve.

2. Cilësia e kredisë

- Trego strukturën e aktiveve sipas rrezikut, analizo fshirjet e aktiveve duke vlerësuar efektin në totalin e bilancit, rezervat për humbjet (provigjonet) si dhe të zërave jashtë bilancit.
- Analizo portofolin e kredisë, pozicionin financiar të kredimarrësve kryesorë, kreditë për personat e lidhur sipas përcaktimit të ligjit për bankat si dhe pozicionin e tyre financiar.
- Trego asetet që sjellin interes dhe ato që nuk sjellin interes dhe analizo lidhjen mes tyre. Prezanto strukturën dhe nivelin e të drejtave ndaj bankave dhe komento mbi cilësinë e tyre.
- Analizo transaksionet e kryera në emër dhe për llogari të personave të tretë dhe vlerëso përshtatshmërinë e klasifikimit të këtyre transaksioneve lidhur me rrezikun që përfaqësojnë.

3. Treguesit e performancës së biznesit dhe ekspozimet sipas rreziqeve

- Specifiko periudhat kur banka ka shkelur kërkesat rregullative të Bankës së Shqipërisë lidhur me mjaftueshmërinë e kapitalit, treguesit e ekspozimeve me rrezik, treguesit e likuiditetit, pozicionit të hapur valutor.
- Vlerëso nëse banka ka adoptuar rregulla, të cilat sigurojnë kontrollin dhe zbatimin me konsistencë të procedurave lidhur me administrimin e rreziqeve, si dhe procedura për raportimin periodik në strukturat drejtuese të bankës si dhe pranë Bankës së Shqipërisë të çështjeve që lidhen me administrimin e rreziqeve.

4. Mjaftueshmëria e kapitalit

- Vlerëso nëse banka ka siguruar një nivel të mjaftueshëm kapitali proporcional me natyrën e biznesit, aktivitetet dhe ekspozimet me rrezik, sipas kërkesave të Bankës së Shqipërisë, në rast se për shkak të kompleksitetit të rreziqeve dhe natyrës së aktiviteteve dhe praktikave të administrimit të rreziqeve, bankës i është kërkuar një nivel mjaftueshmërie kapitali më i lartë sesa niveli minimal.
- Të vlerësojë nëse banka ka procedura për monitorimin dhe vlerësimin e nivelit të kapitalit duke konsideruar ekspozimet aktuale ose të pritshme sipas rreziqeve.

5. Rreziku i kredisë

- Vlerëso nëse banka ka adoptuar politika për administrimin e rrezikut të kredisë.
- Vlerëso nëse banka ka procedura të brendshme të përshtatshme për identifikimin, matjen dhe vlerësimin e rrezikut të kredisë. Vlerëso nëse banka ka një plan për menaxhimin dhe kontrollin e rrezikut të kredisë, si dhe nëse ka procedura të përshtatshme për implementimin e tyre.
- Vlerëso nëse banka ka procedura të përshtatshme për mbledhjen e kredive në kohë, fshirjen e kredive të këqija, si dhe rikuperimin e kredive të fshira.

6. Likuiditeti

- Analizo maturitetet sipas të drejtave dhe detyrimeve, shpjego politikën e bankës për

administrimin e rrezikut të likuiditetit (mënyrën në të cilën banka siguron përputhshmërinë mes të hyrave dhe të dalave të *cash*-it, apo mënyrën se si banka parandalon mungesën e përputhshmërisë në këtë aspekt), shpjego metodologjinë për monitorimin e hyrjeve në "cash" dhe daljeve në "cash", si dhe kufizimin e mospërputhshmërisë.

- Vlerëso treguesit e kredisë ndaj depozita, aktive likuide ndaj totalit të aktiveve, dhe treguesit e tjerë të përcaktuar në kuadrin rregullativ të Bankës së Shqipërisë. Komento mbi rrezikun e përqendrimit të depozitave dhe të ndonjë huamarrjeje nga Banka e Shqipërisë.

- Vlerëso nëse banka ka adoptuar një politikë të administrimit të rrezikut dhe siguro një koment duke specifikuar nëse banka ka procedura të brendshme të mjaftueshme për llogaritjen dhe matjen e rrezikut të likuiditetit, nëse banka ka një plan për administrimin e likuiditetit për raste të jashtëzakonshme dhe procedura të përshtatshme për implementimin e tij, si dhe një sistem informacioni të përshtatshëm që siguron informacion në kohë dhe në vazhdimësi për administrimin e likuiditetit.

7. Rreziku nga këmbimet valutore

- Komento mbi ekspozimin e bankës ndaj rrezikut të këmbimeve valutore në datën 31 dhjetor, datë për të cilën auditimi realizohet. Komento mbi ecurinë vjetore të pozicionit të hapur valutor në raport me mjaftueshmërinë e kapitalit.

- Vlerëso nëse banka ka adoptuar një politikë për administrimin e rrezikut nga këmbimet, shpjego sistemin e kufizimeve apo limiteve (kufijve) të brendshme të bankës lidhur me madhësinë e ekspozimit, si dhe vlerëso nëse banka ka procedura të brendshme të përshtatshme për identifikimin dhe matjen rrezikut nga këmbimet valutore.

8. Rreziku i normës së interesit

- Analizo raportet lidhur me matjen e rrezikut të normës së interesit për të gjitha aktivet, detyrimet dhe zërat jashtë bilancit, duke siguruar një koment për ekspozimin ndaj këtij rreziku.

- Specifiko nëse banka ka adoptuar politika për administrimin e rrezikut të normës së interesit, shpjego masat e marra nga banka lidhur me kufizimin e impaktit të vendimeve lidhur me ndryshimin e normës së interesit për kreditë dhe depozitat.

- Vlerëso nëse banka ka procedura të brendshme të përshtatshme për administrimin dhe kontrollin e rrezikut të normës së interesit, komento nëse banka ka një tërësi instrumentesh për kontrollin dhe administrimin e këtij rreziku, si dhe procedura të brendshme të përshtatshme për vënien në punë të tyre.

9. Rreziku i përqendrimit ndaj një kundërpartie (ekspozimet e mëdha)

- Vlerëso nëse banka ka adoptuar një politikë për administrimin e rrezikut të përqendrimit kundrejt një kundërpartie apo një grupi personash të lidhur, si dhe kundrejt personave të lidhur me bankën. Komento mbi madhësinë dhe ecurinë e këtij ekspozimi.

10. Rreziku i investimeve

- Vlerëso nëse banka ka adoptuar një politikë investimi lidhur me investimet në subjekte të tjera si dhe në aktive fikse.

- Komento mbi investimet me peshë të rëndësishme sipas sektorëve jofinanciarë dhe në total mbi investimet e bankës në subjekte jashtë sektorit financiar, si dhe aktivet fikse.

11. Rreziku operacional

- Vlerëso nëse banka ka adoptuar një politikë për administrimin e rrezikut operacional dhe komento mbi të. Vlerëso nëse banka ka procedura të brendshme të përshtatshme për identifikimin dhe matjen e rrezikut operacional dhe komento mbi të.

- Komento mbi metodologjinë e brendshme të bankës për ruajtjen dhe klasifikimin e humbjeve operacionale sipas kategorive që evidentojnë burimin e rrezikut.

12. Rreziku i vendit

- Vlerëso nëse banka ka adoptuar një politikë për administrimin e rrezikut të vendit dhe komento mbi të. Vlerëso nëse banka ka procedura të brendshme të përshtatshme për identifikimin dhe matjen e rrezikut të vendit si dhe komento mbi të. Komento mbi limitet (kufijtë) e ekspozimit ndaj këtij rreziku.

13. Burimet njerëzore dhe aftësitë organizative

- Paraqit strukturën e personelit të bankës, duke specifikuar numrin total të punonjësve,

menaxhimin, ekspertët, këshilltarët, anëtarët e Këshillit Drejtues (emri, mbiemri, si dhe emri i entitetit ku është i punësuar) si dhe bordin ekzekutiv të bankës. Specifiko në bruto dhe neto kompensimin për kryetarin e Këshillit Drejtues, shumën e agreguar të kompensimit për anëtarët e tjerë të këshillit. Specifiko në bruto dhe neto kompensimin për Drejtorin e Përgjithshëm, si dhe shumën e agreguar të kompensimit për anëtarët e tjerë të bordit ekzekutiv. Paraqit strukturën organizative me të gjitha njësitë organizative (degët, njësitë e biznesit, zyrat e përfaqësimit brenda dhe jashtë vendit).

- Përshkruaj dhe komento mbi kapacitetet teknike të bankës-specifiko madhësinë e ambienteve të biznesit të bankës, nëse këto ambiente janë në pronësi të bankës, nëse banka përmbush standardet lidhur me numrin e punonjësve, si dhe nëse pajisjet teknike (kompjuterike) zotërohen nga banka.

14. Sistemet e informacionit dhe përdorimi i teknologjisë

- Përshkruaj organizimin dhe administrimin e sistemit të informacionit dhe përdorimit të teknologjive, duke vlerësuar mjaftueshmërinë, besueshmërinë dhe pajtueshmërinë me aktivitetet e bankës. Vlerëso nivelin e mbrojtjes së të dhënave dhe informacionit si dhe vlerëso nivelin e teknologjisë së përdorur.